

Deklarata e miratimit

mbiemri dhe emri i pacientit/pacientes:

datëlindja:

Ju lutem vini një kryq (Një deklaratë miratimi pa kryq vlen për të dyja fushat):

 Për shfrytëzimin e materialit biologjik dhe të të dhënave shëndetësore për kërkimin shkencor mjekësor (fleta informuese faqja 1 ose fletorja pjesa A)

Me anë të kësaj jap lejen time,

- që të dhënat e mia shëndetësore (p.sh. dosja ime e pacientit) të bëhen të arritshme për kërkimin shkencor. Lidhur me këtë unë liroj mjeket trajtuese dhe mjekët trajtues nga detyrimi i ruajtjes së sekretit.
- që materiali im biologjik i hequr në ndërmarrjen "Insel Gruppe" për arsye diagnoze ose trajtimi dhe të dhënat e mia gjenetike, që ekzistojnë eventualisht, të përdoren më tej për kërkimin shkencor.

 Për marrjen shtese të gjakut për "Liquid BioBank" Bern (fleta informuese faqja 2 ose fletorja pjesa B)

Me anë të kësaj jap lejen time:

- që për qëllime të kërkimit shkencor të më bëhet një herë një marrje gjaku shtesë (maksimum 20 mililitër, korrespondon me dy tubtha për marrjen e gjakut). Marrja e gjakut do të zhvillohet si vijon:
 - bashkë me një marrje gjaku të rregullt (tubtha shtesë, pa "pickim" shtesë)
 - nëpërmjet sondës ekzistuese që qëndron në venë (ashtuquajtur "Venflon", pa "pickim" shtesë)
 - marrja shtesë e gjakut (nëse asnjë nga të dyja mundësitë e sipërpërmendura nuk është e mundshme)
- që, në rast nevojë, bashkë me marrjen e gjakut mund të nxirren të dhëna shtesë vijuese: shtatlartësia / peshë / etnia (prejardhja, për shembull kaukazian)

Unë konfirmoj, që

- unë mora fletën informuese përkatëse për këtë deklaratë miratimi (versioni V1.0 prej shkurtit 2016), dhe që pata mundësinë të kërkoja fletoren shtese informuese (versioni 2.0 prej shkurtit 2016).
- unë u informova në mënyrë të mjaftueshme rreth përdorimit të mëtejshëm të materialit biologjik dhe të të dhënave shëndetësore për kërkimin shkencor biomjekësor;
- unë pata mundësinë të bëja pyetje dhe që ato u përgjigjen sipas pëlqimit tim;
- miratimi im bëhet nga vullneti im i lirë dhe veçanërisht që unë nuk do të kem as favore as disfavore, pavarësisht se si të vendos unë;
- unë e di që të mund ta tërheq këtë leje në çdo kohë, pa tregim arsyes;
- unë e di që materiali im biologjik dhe të dhënat e mia lejohen t'iu transmetohen institucioneve të tjera brenda ose jashtë vendit për kërkimin shkencor vetëm në formë të shifruar ose anonime;
- unë e di që rregullorja e "Liquid Biobank" Bern në çdo kohë mund të këqyret nën www.biobankbern.ch.
- unë e di që nuk informohem rreth rezultateve të studimeve, edhe nëse ato takojnë shëndetin tim.

vendi, data:

nënshkrimi i pacientes ose i pacientit:

dhe/ose

vendi, data:

nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor (mbiemri dhe emri, nënshkrimi):

Për informacione të mëtejshme ju lutem drejtohuni mjekes suaj / mjekut tuaj ose Drejtorisë për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.